



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË**

**Kryesues i KQZ-së**  
Prof. ass. dr. Arbnor Ajeti

Nr. Prot. 919 Dt 25.04.2023

Në bazë të nenit 8 të Rregullores për zgjedhjet e studentëve, themelimin dhe punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillat e Studentëve në Universitetin "Isa Boletini", në Mitrovicë, Komisioni Qendror Zgjedhor në takimin e mbajtur më 24.04.2023, mori:

**VENDIM**

**Mbi certifikimin e organizatave studentore për Parlament Studentor dhe Këshille të Studentëve**

- I. Certifikohet Organizata Studentore "Fjala Studentore" për Parlament Studentor
- II. Certifikohet Organizata Studentore "Fjala Studentore" për Këshille të studentëve, për fakultetet si në vazhdim:  
Fakulteti i Gjeoshkencave; Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore; Fakulteti Juridik;  
Fakulteti Ekonomik; Fakulteti i Edukimit dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike.

**ARSYETIM**

KQZ në mbledhjen e mbajtur më 24.04.2023 shqyrtoi aplikacionet dhe listat mbështetëse të Organizatave Studentore për certifikim në zgjedhjet studentore 2023. Organizatat Studentore të cilat dorëzuan aplikacionet për certifikim ishin: "Fjala Studentore", "Zëri Studentor" dhe "Koha Studentore". Pas shqyrtimit të listave mbështetëse në përputhje me nenin 8, paragrafi 6, Organizatat Studentore: "Zëri Studentor" dhe "Koha Studentore", nuk plotësuan kushtet e parapara për certifikim, ndërsa Organizata Studentore "Fjala Studentore", përmbushi kushtet e parapara me rregullore dhe nenin e lartëcekur, andaj u vendos si në dispozitiv të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- Organizatave studentore
- Komisionit Qendror Zgjedhor
- Kryesuesve të Komisioneve të fakultetit
- Arkivit të Universitetit

**Këshillë juridike:** Organizatat studentore mund të paraqesin ankesë pranë Komisionit Qendror Zgjedhor në Rektoratin e UIBM, në afat prej 24 orësh nga publikimi i këtij vendimi.

Prof. ass. dr. Arbnor Ajeti

Kryesues i KQZ-së

